



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:048452
Datë: 21.08.2024
Numri i dokumentit: 06070569

KPPP.nr.298/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit të përmbarimit "Ndal Tech" me numër unik identifikues 811460849, me adresë në Rr. "Ukshin Kovaçica" p.n, në Prishtinë, kundër debitorit "Lorenco & Co" SHPK, -Dega në Kosovë, me numër unik identifikues 810818130, me pronar L.Z., me adresë në Rr. "Bekim Fehmiu, Icon Tower", kati 11, Nr.2, që ka të bëjë me pagesën e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm / faturës, jashtë seancës me datën 21.08.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET I TËRHEQUR propozimi për përmbarim i kreditorit "Ndal Tech" me numër unik identifikues 811460849, me adresë në Rr. "Ukshin Kovaçica" p.n, në Prishtinë në çështjen juridike përmbarimore të iniciuar sipas Urdhrit të Përmbaruesit Privat Flamur Bogaj, me seli në Prishtinë, P.nr.3062/23 të datës 27.12.2023, sipas njoftimit për tërheqjen nga propozimi për përmbarim të kreditorit, të datës 07.08.2024.
- II. PËRFUNDOHET procedura përmbarimore KPPP.nr.298/2024 dhe abrogohen të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë çështje përmbarimore.

A r s y e t i m

Kreditori, me datën 27.12.2023 ka iniciuar propozimin për përmbarrim ndaj debitorit pranë organit përmbarrues Flamur Bogaj me seli në Prishtinë, për shkak të borxhit nga dokumenti i besueshëm/ faturat- dhe atë fatura me numër 71-210-001-23, e datës 21.12.2023, në vlerë prej 72,212,12 Euro.

Kreditori, me datën 07.08.2024 në Gjykatën Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, ka dorëzuar parashtrësë me shkrim me të cilën e ka njoftuar gjykatën për tërheqje nga propozimi për përmbarrim në këtë çështje përmbarrimore, duke kërkuar që të mos ndërmerret asnjë veprim në këtë çështje dhe të konsiderohen të anuluar të gjitha veprimet e ndërmarra deri më tani lidhur me këtë lëndë.

Gjykata mori parasysh deklarin e kreditorit në parashtrësën e deponuar në këtë gjykatë, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 42 par.1 të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore, ku përcaktohet se *“Propozimi për përmbarrim mund të tërhiqet tërësisht apo pjesërisht nga kreditori gjatë zhvillimit të procedurës përmbarrimore pa pëlqimin e debitorit.*

Ndërkaq, në par.2 të këtij neni përcaktohet se *“Në rast të tërheqjes së propozimit për përmbarrim organi përmbarrues e përfundon përmbarrimin në tërësi apo pjesërisht, varësisht nga ajo se a është tërhequr ai në tërësi apo vetëm pjesërisht.*

Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi pasi që mungon interesi juridik i kreditorit për t’u trajtuar kjo çështje më tutje në gjykatë.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.298/24, me datë 21.08.2024

Gjyqtar
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.